



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.452/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.02.2025, merr këtë,

#### VE N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.452/2025, e datës 07.02.2025, e parashtruar nga subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje LVV, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

#### A r s y e t i m

Me datë 07.02.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, Anr.452/2025, pretendohet se më datë 29 janar 2025, në ora 18:54/h, kandidati për deputet nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Ilir Gashi, ka publikuar një fotografi në rrjetin social Facebook, në ambientet e Bashkësisë Islame në Komunën Prizren, me qëllim të përfitimit të votave, ndër të tjerash në tekstin shoqërues deklaroi: "Me këtë rast i përkujtuam edhe zotimet për Qeverinë Kurti 3, me të cilën parashikohet mbështetja e bizneseve me subvencionimin e pagave për 6 muaj në Punësimin e grave mbi 40 vjeç..." Më tej në ankesë pretendohet se PZAP-i, me vendimin Anr.269/2025, te datës 01.02.2025, ka shpallur përgjegjës subjektin politik LVV për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i ka shqiptuar dënimi me gjobë edhe pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi, postimi vazhdon të jetë aktiv në profilin e z. Ilir Gashi. PDK vlerëson se në veprimet kandidatëve Ilir Gashi, janë konsumuar të gjitha elementet e veprimit të ndaluar, të përcaktuar në nenin 5, par. 2, nën par. 2.4 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar. Provë: Linku i postimi në rrjetin social Facebook <https://ëëë.facebook.com/reel/500276346000244>;

Në përgjigjen në ankesë të datës 09.02.2025, theksohet se Lëvizja Vetëvendosje LVV, të gjithë anëtarët e saj i ka njoftuar me rregullat zgjedhore të cilat janë përcaktuar me LZP dhe Rregullat e miratuara nga KQZ në lidhje me fushatën zgjedhore dhe të njëjtin i ka udhëzuar të respektojnë këto rregulla. Më tej në përgjigje, LVV njofton PZAP-in, se postimi në Facebook i z.Illir Gashi objekt i kësaj anekese është hequr nga rrjeti social Facebook.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës se postimi i Ilir Gashit është ende aktiv, Paneli vlerësoi se pretendimet e parashtruara me ankesë nga subjekti politik PDK janë të pa bazuara, kjo për faktin se nga ankuesi janë prezantuar provat e njëjta për të cilat Paneli tashme ka marrë vendim dhe mbi bazën e provave të njëjta nuk mund të shqiptoj gjohë për subjektin politik LVV. Andaj Paneli thekson se nuk janë prezantuar prova të reja që tregojnë se ende ekzistojnë postimet për të cilat pala pretendohet në ankesë, ndërsa nga hetimi që është bërë nga PZAP-i nuk rezulton se i njëjti postim është ende aktiv në rrjetet sociale të kandidatit Ilir Gashi.

Prandaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës si dhe nga hetimi i ndërmarr nga PZAP-ja nuk ka arritur të dëshmoj se postimi është aktiv, qe do të thotë, se me provat e paraqitura nuk është vërtetuar se ka shkelje të dispozitave të lartcekura të Rregullores Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, siç pretendohet në ankesën e lartcekur, dhe si të tillë të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Anr.452/2025, datë 10.02.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.